

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve, Sadushi: Vendimin përfundimtar e merr Gjykata Kushtetuese - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/pagat-e-magjistrateve-sadushi-vendimin-perfundimtar-e-merr-gjykata-kushtetuese/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:35:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:35:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	07ae02bcbf6ce1c11e1b248fe10d32dbb45fd7109c19750f2ece0894257cb61e
TEKSTI	bc3d57fea6f21437459c8214421b2ebbaafab036829ed168b855675444d8d375
PAMJA	d1d6104da7499ccebdf555a1358e1c96fcaf57dd290b39b7efa338b3a8651679

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3cb38c7ef7e995fa489296aae18ffc3bd33be1e959f7d3f5aba64bad27d830a3d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3cb38c7ef7e995fa489296aae18ffc3bd33be1e959f7d3f5aba64bad27d830a3d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump Benjamin Netanyahu Viora Hyseni Edi Rama Inteligjenca Artificiale

LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT

Pagat e magistratëve, Sadushi: Vendimin përfundimtar e merr Gjykata Kushtetuese

25 Shtator 2026 | 10:35

Kreu i Gjykatës së Lartë, Sokol Sadushi, mbajti një fjalë përshëndetëse në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve të Republikës, ku u ndal edhe te debati për pagat e magistratëve dhe marrëdhëniet ndërmjet pushteteve.

Sadushi tha se për mosmarrëveshjen rreth ligjit për pagat e magistratëve do të vendosë përfundimisht Gjykata Kushtetuese, duke theksuar se Kushtetuta dhe vendimet e saj nuk mund të zëvendësohen nga një tryezë dialogu. Ai iu referua edhe tryezës së konsultimit të thirrur nga Kryeministri me drejtuesit e institucioneve të drejtësisë, duke sqaruar se objekti i saj është politika e pagave dhe mekanizmi për përcaktimin e tyre.

"Për sa kohë ligji dhe pretendimet kushtetuese të ngritura ndaj tij janë në shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese, themeli juridik i kësaj mosmarrëveshjeje nuk mund të negociohet në një tryezë tjetër", tha Sadushi. Sipas tij, kjo nuk do të thotë mbyllje e dialogut institucional, pasi "dialogu nuk është nënshtrim", por mënyrë për të mbrojtur qëndrimet me argumente dhe për të gjetur hapësira bashkëpunimi.

Sadushi vlerësoi se dialogu ndërmjet pushteteve duhet të shkojë përtej çështjes së pagave dhe të përfshijë problemet që lidhen me funksionimin e sistemit të drejtësisë. Ai propozoi një "Tryezë për funksionimin dhe konsolidimin e sistemit të drejtësisë", ku të diskutohen numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve, plotësimi i vendeve vakante, stoku i çështjeve dhe kohëzgjatja e proceseve.

Në fjalën e tij, kreu i Gjykatës së Lartë u ndal edhe te nevojat e gjykatave për administratë, teknologji, infrastrukturë, siguri dhe financim të qëndrueshëm. Ai theksoi se funksionimi i sistemit duhet të matet përmes rezultateve dhe aftësisë për t'u ofruar qytetarëve drejtësi cilësore dhe në kohë.

Sadushi foli gjithashtu për sigurinë në gjykata, duke përmendur se më 6 tetor bëhet një vit nga vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja në sallën e gjyqit. Sipas tij, kur siguria e gjyqtarit kërcënohet për shkak të detyrës, vihet nën presion edhe vetë drejtësia, ndërsa garantimi i sigurisë është detyrim i shtetit.

Në përfundim, Sadushi u ndal te zgjedhja e tre anëtarëve të rinj gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke theksuar përgjegjësinë e gjyqtarëve në përzgjedhjen e tyre dhe nevojën që anëtarët e zgjedhur ta justifikojnë besimin e marrë.

LAJMI I FUNDIT

10:22 Shpallen në kërkim babë e bir për plagosjen me armë një ditë më parë në Lezhë

10:20 Rama në Këshillin European të Korporatave: Paqja është kusht për zhvillimin ekonomik

10:15 Terapi dhe rehabilitim, robotët testohen për të ndihmuar të moshuarit në Paris

09:57 Papa Leo XIV nis vizitën e parë në Francë

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

09:51 Zbardhen prapaskenat e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë, emrat e fuqishëm që u ulën në të njëjtën tryezë

09:48 Sulmi në Banjskë, provokojnë serbët; nderojnë agresorët gjatë ndeshjes

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

LAJM KRYESOR | POLITIKË

Rama në Këshillin European të Korporatave: Paqja është kusht për zhvillimin ekonomik

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në edicionin e tetë të Këshillit European të Korporatave, ku në fjalën e tij u ndal te rëndësia e paqes,...

10:20 | 25/09/2026

BOTA | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT

Zbardhen prapaskenat e darkës Trump-Xi në Shtëpinë e Bardhë, emrat e fuqishëm që u ulën në të njëjtën tryezë

Një mbrëmje simbolike në Shtëpinë e Bardhë bashkoi presidentin amerikan Donald Trump dhe homologun e tij kinez Xi Jinping, në përmbyllje të një dite bisedimesh...

09:51 | 25/09/2026

BOTA | LAJM KRYESOR

Iran, Teherani propozon një plan 7-ditor për hapjen e Hormuzit

Irani u ka paraqitur Shteteve të Bashkuara një plan për të rihapur Ngushticën e Hormuzit, tha Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi. Araghchi u tha...

09:17 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.